



VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 21 prill 2015

Lënda nr. 2014-05

Mazlam Ibrahim

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURA

1. Ankesa është regjistruar më 3 shkurt 2014.
2. Më 25 qershor 2014, Paneli ka vendosur ta njoftoj shëfën e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth ankesës, duke e ftuar atë që të parashtrijë vërejtje me shkrim për ankesën. Gjithashtu është vendosur që të shqyrtohen meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (rregulla 30, paragrafët 1 dhe 2 të rregullores së punës së Panelit).

3. Vërejtjet e shefit të Misionit janë pranuar më 13 tetor 2014, ku më pastaj ato janë përkthyer dhe komunikuar ankuesit për vërejtjet e tij shtesë.
4. Më 28 nëntor 2014, ankuesi ka dërguar vërejtje shtesë, të cilat janë dërguar tek shefi i Misionit për informim. Nuk janë kërkuar vërejtje të tjera.

FAKTET

I. RRETHANAT E LËNDËS

5. Ankuesi ishte i punësuar në kompaninë "IT DRATEX" në Dragash nga viti 1984 deri në qershor 1999, kur ishte detyruar të largohej nga Kosova për shkaqe sigurie. Tani ai është i papunë dhe jeton në Republikën e Serbisë.
6. Më 30 tetor 2006, ai ka paraqitur një kërkesë për pagesën e pagave të papaguara në vlerë prej 6,000 euro (gjashtë mijë euro) në zyrën e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në Beograd.
7. Më 24 prill 2013, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP-ja, pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit) ka refuzuar kërkesën. AKP-ja ka gjetur se ajo ishte parashtruar shumë herët, sepse procedurat për likuidimin e "IT DRATEX" nuk kishin filluar ende.
8. Më 17 qershor 2013, ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër vendimit të AKP-së në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DhPGJS). Ai ka kërkuar gjithashtu që të lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore dhe shpenzimeve të përkthimit të aplikacioneve dhe dokumenteve shtesë në gjuhën angleze (siç kërkohet nga neni 25.8 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rregullorja e punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji mbi DhPGJS)). Ai ka argumentuar se ishte person i zhvendosur, i papunë dhe me aftësi të kufizuara, në një situatë të vështirë financiare, e në atë mënyrë pagesa e këtyre shpenzimeve do ta rrezikonte edhe ekzistencën e tij dhe të familjes së tij. Ai gjithashtu ka parashtruar dokumentet përkatëse si kopjet e librezës së regjistrimit të DhPGJS-së dhe certifikatën e Shërbimit Kombëtar për Punësim. Këto kanë konfirmuar se ai ka marrë ndihmë të përkohshme sociale mujore prej 5,684.00 DRS (përafërsisht. 50,00 EURO).
9. Më 5 nëntor 2013, një gjykatës i EULEX-it në trupin gjykues në kuadër të DhPGJS-së ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit. Arsyetimi i vendimit nuk përmban ndonjë referencë rreth fakteve të paraqitura nga ankuesi, as nuk ofron ndonjë arsyetim rreth vendimit. Aty vetëm thuhet se në bazë të "nenit 25.10, aneksin e Ligjit Nr.04/L-

33 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkthimi i parashtrësve dhe dokumenteve përcjellëse është marrë nga Dhoma e Posaçme me shpenzimet e ankuesit”.

10. Ankuesi ka parashtruar ankesë kundër vendimit të mësipërm, i cili me sa duket ende nuk është shqyrtuar nga DhPGJS-ja.
11. Lënda është ende e pazgjidhur pranë DhPGJS-së.

II. ANKESAT

12. Ankuesi pretendon në shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (Deklarata):
 - Neni 6 i Konventës dhe neni 10 i Deklaratës (e drejta për gjykim të drejtë, në veçanti e drejta për qasje në gjykatë). Ankuesi pohon se tarifat shumë të larta gjyqësore dhe shpenzimet e përkthimit shkelin qasjen e tij të drejtë në gjykatë. Për më tepër, vendimi që i ka mohuar atij përjashtimin nga taksat gjyqësore dhe shpenzimet e përkthimit nuk kanë dhënë asnjë arsytim, kështu që në këtë mënyrë janë shkelur të drejtën e tij për një vendim të arsyeshëm;
 - Neni 13 i Konventës dhe neni 32 i Deklaratës (e drejta për një zgjidhje efektive). Ankuesi pohon se nuk mund të ketë ankesa ndaj vendimit të DhPGJS-së dhe kjo përbën shkelje të së drejtës së tij për një zgjidhje efektive;
 - Neni 14 i Konventës dhe neni 2 i Deklaratës (e drejta për barazi para ligjit dhe mosdiskriminim). Ankuesi pretendon se ai ishte diskriminuar mbi baza etnike, sepse ai është i përkatësisë etnike serbe.

III. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

**SHTOJCA E LIGJIT Nr.04/L-033
E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
LIDHUR ME ÇËSHTJET E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

**RREGULLORJA E PUNËS E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS
SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENCISË
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
(siç zbatohet në atë kohë)**

**Neni 25
Parashtrimi i lutjeve**

....

8. Lutjet dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe duhet të shoqërohen nga një përkthim në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit i bartë pala që dorëzon atë lutje dhe ato dokumente.

9. Një person fizik mund t'i paraqesë kërkesë kryesuesit të Kolegjit për ndihmë rreth përkthimit në gjuhën angleze të lutjeve dhe dokumenteve përcjellëse. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet bashkë me parashtrirat dhe duhet të përfshijë një pasqyrë financiare të mjeteve të palës dhe çfarëdo dëshmie mbështetëse që pala dëshiron që gjyqtari kryesues të marrë parasysh.

10. Gjyqtari kryesues mund të vendosë që përkthimi i lutjeve dhe i dokumenteve përcjellëse që kërkohen sipas paragrafit 8 të këtij neni të bëhet me shpenzimet e Dhomës së Posaçme, nëse ai apo ajo mendon se ky vendim është i arsyeshëm, duke pasur parasysh mjetet financiare të personit fizik. Nëse Kryesuesi i Kolegjit refuzon një kërkesë të tillë, ai duhet ta njoftojë palën me vendim me shkrim dhe të urdhërojë atë person që t'i sigurojë përkthimet në gjuhën angleze me shpenzimet e tij brenda afatit që përcaktohet në vendim. Nëse përkthimet nuk sigurohen brenda këtij afati, Dhoma e Posaçme urdhëron përkthimin e dokumenteve dhe shpenzimet ia ngarkon personit në fjalë.

Më 29 mars 2014, ligji i mësipërm është ndryshuar si në vijim:

Ligji Nr. 04/L-246

LIGJI NR. 04/L-246 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-033 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 2

1. Neni 25 i Shtojcës së Ligjit bazik, paragrafi 8 riformulohet me tekstin si në vijim:

8. Të gjitha kërkesat dhe dokumentet përcjellëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, kurse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të sigurojë, me propozimin dhe burimet e saj, përkthimin e tyre në gjuhën angleze.

2. Neni 25 i Shtojcës së Ligjit bazik, paragrafët 9 dhe 10 fshihen në tërësi.

LIGJI

Parashtrirat nga palët

13. Në parashtrimet e tij, ShM pohon se as DhPGJS-ja e as Gjykata Supreme e Kosovës nuk janë institucione të EULEX-it, por ato janë gjykata në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës, edhe pse një numër i gjyqtarëve të EULEX-it punojnë në DhPGJS dhe se një gjykatës i EULEX-it ka vendosur në këtë lëndë. Megjithatë, as ShM e as ndonjë pjesëtar tjetër i stafit të EULEX-it nuk mund të ndikoj në

vendimet e gjykatësve të pavarur. Prandaj, vendimi i DhPGJS-së i datës 5 nëntor 2013 thjesht është një vendim i një gjykate të Kosovës. Pasi që Paneli nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës, ankesa bie jashtë juridiksionit të tij. Prandaj ajo duhet të shpallet e papranueshme.

14. Pavarësisht prej këtyre parashtrësive, ShM adreson shkeljen e supozuar të nenit 6 të Konventës dhe nenit 10 të Deklaratës. ShM pohon se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute dhe i nënshtrohet kufizimeve të caktuara. Një skemë e pagesave sa i përket procedurave civile në përgjithësi pranohen si kufizim i ligjshëm ndaj së drejtën për në gjykatë. Në rastin në fjalë, ankuesit nuk ju është mohuar ndihma juridike me vendimin e gjykatës për refuzimin e kërkesës tij për t'u liruar nga shpenzimet. Prandaj, ai do të duhet të paguaj një tarifë, shuma e së cilës do të përcaktohet në fund të procedurës. Kjo tarifë mund t'i kompensohet në qoftë se kërkesa e tij është e suksesshme.
15. ShM më tej pohon se Ligji për DhPGJS-në është ndryshuar dhe aplikantëve nuk ju ngarkohen më shpenzimet për përkthim. ShM nuk saktëson se a zbatohen dispozitat e reja në procedurat e nisura para amendamenteve.
16. Në përgjigje ndaj vërejtjeve të ShM-së, ankuesi pohon se ai mbështet parashtrësat e tij. Ai pranon se Ligji për DhPGJS-në është ndryshuar dhe se barra e shpenzimeve të përkthimit më nuk mbulohet nga palët në procedurë. Megjithatë sipas kësaj pikëpamje, kjo tregon se ankesa e tij ishte e bazuar.
17. Sa i përket mandatit të Panelit për ta shqyrtuar lëndën e tij, ankuesi thekson se refuzimi i ankesës për shkak të mungesës së juridiksionit do të çojë në një boshllëk ligjor, pasi nuk do të ketë asnjë mekanizëm kontrolli mbi punën e gjykatësve të EULEX-it. As Këshilli Gjyqësor i Kosovës e as ndonjë autoritet tjetër i Kosovës nuk do të ketë juridiksion mbi lëndën. Si pasojë, nuk do të ketë siguri juridike, nuk do të ketë kufizime të veprimeve diskrecionale nga gjykatësit apo ndonjë kontroll efikas mbi punën e tyre.
18. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 6 të Konventës, ankuesi pohon se mungesa e arsytimit të mjaftueshëm e vendimit përkatës çon në shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe çon drejt pasigurisë ligjore, pasi palët në procedurë nuk kanë qasje në rregulloret mjaft precize rreth lirimit nga pagesa e taksave gjyqësore dhe shpenzimeve.

Vlerësimi i Panelit

19. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë

për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

20. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
21. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i referohet çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me drejtësinë, policinë dhe doganën.
22. Paneli thekson se ankesa e ankuesit ka të bëjë me qasjen e tij në procedurën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.
23. Paneli përsërit se në bazë të rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih në mesin e shumë të tjerëve *Fahri Rexhepi kundër EULEX-it*, nr. 2014-19, 10 nëntor 2014 , § 12; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014 § 13).
24. Prandaj, Paneli në parim nuk mund t'i shqyrtoj vendimet e gjykatësve të EULEX-it si të tilla. Megjithatë, Paneli tashmë ka konstatuar se në rrethana të caktuara, juridiksioni i Panelit do të mbuloj vendimet dhe aktet e autoriteteve gjyqësore si të tilla, në veçanti ku akuzat e besueshme për shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen gjykatësve të EULEX-it nuk janë trajtuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore në procedura ankimore (*Tomë Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2014-04 27 maj 2014 § 15).
25. Paneli këtu rikujton se neni 6 § 1 përfshinë “të drejtën për gjykim”, nga e cila e drejta për qasje, pra e drejta për të nisur procedurat në një gjykatë në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt; megjithatë, ajo është një aspekt që në thelb lejon atë të përfitojë nga garancitë e tjera të referuara në paragrafin 1 të nenit nr. 6. Karakteristikat e drejta, publike dhe të shpejta të procedurave gjyqësore janë me të vërtetë të pavlefshme nëse procedurat e tilla fillimisht nuk kanë nisur. E në çështjet civile vështirë se mund të imagjinohet sundimi i ligjit pa pasur aty mundësi për të pasur qasje në gjykatë (shih, në mesin e shumë

vendime të tjera, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 21 janar 1975, §§ 34 in fine dhe 35-36, seria A nr. 18,. Z. dhe të tjerët kundër Mbretëria e Bashkuar [GC], nr. 29392/95, §§ 91-93, KEDNJ 2001-V, dhe *Kreuz kundër Polonisë*, nr. 28249/95, § 52, KEDNJ 2001-VI).

26. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund t'i nënshtrohet kufizimeve. Garantimi për palët në të drejtën efektive në qasje në gjykatë për përcaktimin e “të drejtave civile dhe detyrimeve” të tyre, neni 6 § 1, i lë autoriteteve një zgjedhje të lirë rreth mënyrave që do të përdoren për këtë qëllim. Megjithatë, kufizimet e zbatuara nuk duhet të kufizojnë apo reduktojnë qasjen që iu është ofruar aplikuesit në atë mënyrë apo në atë masë sa që esenca e kësaj të drejte të dëmtohet (shih *Kreuz*, i cituar më lartë, §§ 53-54).
27. Paneli thekson se kërkesa për të siguruar përkthimin e dokumenteve përkatëse në gjuhën angleze mund të përbëjë një barrë të rëndë për disa ankues, p.sh. për ankuesin, i cili është një person i papunë i ZhVBV dhe jeton me asistencë modeste sociale. Përveç kësaj, dispozitat e Ligjit nr. 04/I-033 janë gjetur se nuk janë në harmoni me Kushtetutën dhe Ligjin e Kosovës për përdorimin e gjuhëve, të cilat të dyja këto parashohin se gjuha shqipe dhe serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë, të cilat përdoren në të gjitha institucionet e saj. Rrjedhimisht, ligji është ndryshuar në atë mënyrë që përputhet me kërkesat kushtetuese. Kjo nuk do të duket se amendamentet do të ketë ndonjë ndikim në situatën e tanishme të ankuesit.
28. Megjithatë Paneli vëren se vendimi i marrë nga gjyqtari i DhPGJS-së së EULEX-it nuk i ka dhënë fund procedurës. Rasti kryesor në fakt është ende i pazgjidhur dhe do të vendoset në një fazë të mëvonshme. Në këtë rast, ka një dallim me rastin *Kreuz*, të cituar më lartë në par. 23, në atë se inicimi i procedurës pranë DhPGJS-së nuk varet nga pagesa e ndonjë tarife apo shpenzimi për përkthim, mirëpo ato vetëm se janë vonuar. Del se vendimi për të mos përjashtuar parashtruesin e ankesës nga shpenzimet e procedurës nuk shkel të drejtën e tij për të pasur qasje në gjykatë (shih *Urbanek kundër Austria*, nr. 35123/05, §§ 55-56, 9 dhjetor 2010). Për më tepër, kjo do të duket se meritat e ankesës së ankuesit kundër vendimit në fjalë ende nuk janë shqyrtuar.
29. Nëse ankesa e tij do të jetë e pasuksesshme, ankuesi ka mundësinë ta paraqes ankesën e tij pranë trupit gjykues të DhPGJS-së. Atëherë do të merret një vendim përfundimtar mbi shpenzimet. Ky vendim sipas nenit 12 të Ligjit të DhPGJS-së mund të jetë në favor të ankuesit, i cili më pas mund të mos jetë i detyruar të bartë shpenzimet.
30. Kjo bën që ankesa e tij parashtruar Panelit të jetë e parakohshme, prandaj Paneli konstaton se tani për tani kjo ankesë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri,

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese